



Në bazë të nenit 10.1 pika b), nenin 13.1 pika a) nenit 14 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Tokën Bujqësore, nr.02/L-26, nenit 6 pika 6.2 dhe nenit 8 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nr.41/2006, nenit 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 46 të Statutit të Komunës së Klinës, 01nr. 01-110-1232/2010, të dt.31.03.2010, propozimin e Kryetarit të Komunës të dt.18.03.2015 dhe së fundmi duke iu referuar edhe pëlqimit të MBPZHR, ref.ZSP.571/15 të dt.09/07/2015, Kuvendi i Komunës në seancën e vet të rregullt të-IV me radhe të mbajtur me datën 29/04/2016, mori këtë:


V E N D I M

- I. LEJOHET, ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës kadastrale **P-71011046-00279-1**, e cila është e evidentuar në emër, pronë shoqërore, Kuvendi Komunal Klinë, sipas certifikatës pronësore, nr.10-8954, të dt.19.10.2015 ZK Këpuz, Komuna e Klinës, me sipërfaqe prej 1000m² (10 ari) me kulturë kullosë e klasit të parë, vendi i quajtur "Kuqlina".
- II. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore është i përhershëm dhe bëhet pa pagesën e ndërrimit të destinimit të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore.
- III. Ndërrimi i destinimit bëhet me qëllimi të harmonizimit të gjendjes faktike në terren me gjendjen kadastrale, për formim të parcelës në mënyrë që të krijohen kushtet për shfrytëzim racional të saj.
- IV. Obligohet Drejtoria e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë që të bëjë ndryshimet përkatëse kadastrale në labrat kadastralë, në bazë të Vendimit përkatës, ashtu që në vend të tretmanit *tokë bujqësore*, të evidentohet tretmani, *toke ndërtimore*, në emër të Komunës së Klinës.
- V. Pjese përbërëse të këtij Vendimi janë: Propozimi i Kryetarit të Komunës, nr.01-464-2101/2015 i dt.18.03.2015, Pëlqimi i MBPZHR, ref.ZSP.571/15 të dt.09.07.2015, certifikata pronësore, nr.10-8954.
- VI. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Bujqësisë dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë në Klinë.

- VII. Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e konfirmimit të ligjshmërisë së tij nga MAPL-ja, përkatësisht 15 ditë pas protokollimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.
- VIII. Me Vendim të njoftohen: MAPL-ja, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillim Rural, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Kadastrit Gjeodezisë dhe Pronësisë, Kryetari, si dhe Arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS-KLINË

01Nr. 06-2344 /2016
Klinë, me 29.04.2016



Kryesuesi,
Dr. Haxhi Ibishi